Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

| | |
|---|---|
| Datë/Datum/Date: | 30.11.2021 |
| Për/Za/To: | Komisionin Parlamentar per Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Infrastrukture dhe Mjedis te Kuvendit te Republikës se Kosovës |
| Nga/Od/From: | **Z. Bujar Ejupi**, Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës |
| Lënda/Subjekat/Subject: | **Plani i Performancës i Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2022** |

Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës është themeluar si agjenci e pavarur rregullatore në bazë të nenit 14 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil. Nga 1 janari 2009, AAC ka marrë kompetencat e plota në përputhje me këtë ligj. AAC është njëra nga autoritetet publike me përgjegjësi dhe funksione në fushën e aviacionit civil në vendin tonë.

AAC është e ngarkuar me rregullimin e aspekteve të sigurisë së aviacionit civil dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror. Rregullimi ekonomik i aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror nënkupton miratimin e tarifave për shfrytëzimin e shërbimeve që ofrojnë këta operatorë. AAC ka kapacitet të plotë juridik dhe për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

AAC është organizatë me të hyra buxhetore dhe autoritet publik dhe iu nënshtrohet dispozitave përkatëse mbi organizatat buxhetore dhe autoritetet publike në ligjet dhe aktet e tjera nënligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

AAC ka hartuar dhe miratuar Objektivat Strategjike për periudhën 2019-2023. Plani i punës në AAC është i bazuar në objektivat strategjike të AAC-së, zbërthen ato në objektiva operative dhe në veprime të detajuara që rrjedhimisht rezultojnë në pesë dokumente të brendshme që përcillen për realizimin e tyre në çdo tremujor nga menaxhmenti i AAC-së.

# PLANI I PERFORMANCËS I AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL TË KOSOVËS 2022

## 1. Objektivi: ZBATIMI I PLOTË I PËRGJEGJËSIVE RREGULLATORE

Është politikë e AAC-së që të vërtetohet se veprimet e saj janë në përputhshmëri të plotë me Ligjin e Aviacionit Civil, me rolin dhe përgjegjësitë që i janë dhënë Autoritetit përmes këtij ligji. Prandaj, AAC e ka të rëndësishme që përmes veprimeve të caktuara, çdo vit, të veprojë në drejtim të arritjes së zbatimit të plotë të përgjegjësive rregullatore.

*(a) Implementimi i Marrëveshjes mbi Hapësirën e Përbashkët Ajrore Evropiane (HPEA)*
*(b) Plotësimi i legjislacionit sekondar*
*(c) Certifikimi i operatorëve*
*(d) Licencimi i personelit të aviacionit*
*(e) Aprovimi i organizatave trajnuese*
*(f) Mbikëqyrja e vazhdueshme e operatorëve*
*(g) Mirëmbajtja e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë dhe përmirësimi i vazhdueshëm*

**PLANI 2022:**

1.1 Implementimi i Marrëveshjes HPEA

*1.2 Plotësimi i legjislacionit sekondar (Transpozimi i akteve te acquis-së së BE-së dhe hartim i legjislacionit kombëtar)*

1.3 Zbatimi i planit korrektues për adresimin e gjetjeve të EASA-se

1.4 Lëshimi dhe ri-vazhdimi i licencave të personelit të operatorëve dhe lëshimi i lejeve

1.5 Mbikëqyrja e vazhdueshme e operatorëve dhe mbikëqyrja e brendshme

1.5.1 Auditime/Inspektime të sigurisë te operatori ASHNA

1.5.2 Auditime/Inspektime të sigurisë te operatori ANP "Adem Jashari" LKIA

1.5.3 Auditime/Inspektime të sigurisë te shërbyesve në tokë

1.5.4 Auditime/Inspektime të sigurisë në:
- Organizatat e Aprovuara Trajnuese (ATO)
- Për trajtimin e Mallrave të rrezikshme (DGR)
- Aviacionin e përgjithshëm (GAT)
- Mjekësinë e aviacionit (MED)
- Inspektimet në platformë (SAFA)
- Organizatave trajnuese ne fushën e aerodromeve dhe ofruesve te shërbimeve ne toke.

1.5.5 Auditimet e brendshme të sistemit të menaxhimit (sistemi për menaxhim të cilësisë dhe sistemi për menaxhim të sigurisë në aviacion)

1.6 Mbikëqyrja ekonomike e ASHNA-s, ANP "Adem Jashari" LKIA dhe shërbyesve në tokë

1.7 Trajtimi dhe analiza e ndodhive te raportuara ne aviacion

1.8 Miratimi i tarifave të rregulluara aeronautike

1.9 Aranzhimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me autoritet shtetërore për mbrojtjen e mjedisit

1.10 Implementimi i Rregullores për shenjëzimin e pengesave, veçanërisht inspektimi dhe identifikimi i largpërçuesve që kalojnë mbi auto-udhët

1.11 Vlerësimet aeronautike për ndërtimet brenda zonave mbrojtëse të aerodromeve, si dhe objekteve të lartë kudo në territorin e Republikës së Kosovës, veçanërisht të turbinave të erës

2. Objektivi : **ZBATIMI I PROGRAMIT SHTETËROR TË SIGURISË (PShS)**

Zbatimi i Programit Shtetëror të Sigurisë është obligim i Republikës së Kosovës që vjen nga Aneksi 19 i ICAO-së. Qeveria e Kosovës e ka deleguar te Drejtori i Përgjithshëm i AAC përgjegjësinë për përcjelljen dhe koordinimin e zbatimit të këtij obligimi në nivel kombëtar.

Përmes PShS-së, kërkohet hartimi dhe zbatimi i një programi të përbashkët, i cili definon qartë strukturën dhe hierarkinë shtetërore të përgjegjësive në sigurinë e aviacionit civil, definon rolet e hisedarëve dhe koordinimin e punëve në mes tyre. Ky program i definon gjithashtu politikat e shtetit për sigurinë dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi.

Kërkesat e PShS-së grupohen në katër shtylla kryesore,

*(a) Politika dhe objektivat e shtetit për siguri (korniza ligjore për aviacionin civil, ndarja e përgjegjësive për sigurinë e aviacionit brenda shtetit, investigimi i aksidenteve dhe incidenteve dhe politika e shtetit për detyrim të zbatimit të legjislacionit të aviacionit civil)*
*(b) Menaxhimi i riskut të sigurisë (kërkesat e shtetit për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë (SMS) për operatorë, marrëveshja për performancën e sigurisë nga operatorët, indikatorët shtetërorë të sigurisë)*
*(c) Garantimi i sigurisë(Mbikëqyrja e sigurisë, mbledhja, analizimi dhe shkëmbimi i të dhënave të sigurisë, identifikimi i fushave më të ndjeshme në bazë të të dhënave të sigurisë)*
*(d) Promovimi i sigurisë(trajnimet e brendshme dhe të jashtme, komunikimi dhe shpërndarja e informatave)*

**PLANI 2022:**

Për zbatimin e PShS-së dhe arritjen e një pjekurie të këtij programi nevojitet një kohë dhe planifikim më afatgjatë pasi që numri i kërkesave është i madh dhe për realizimin e tyre janë

përgjegjëse më shumë institucione me rol në sigurinë e aviacionit civil bashkë me operatorët aeronautik, megjithatë AAC si përgjegjëse për realizimin e shumicës nga kërkesat dhe përgjegjëse për koordinimin e realizimit të këtij programi, me përkushtim planifikon dhe realizon veprime drejt arritjes së këtij objektivi.

2.1 Zbatimi i kërkesave të PShS-së të ndërlidhura vetëm me AAC-në

2.2.1 Koordinim i veprimeve me institucione dhe operatorë me rol në PShS

## 3. Objektivi: NORMALIZIMI I HAPËSIRËS AJRORE

Hapësira e lartë ajrore e Republikës së Kosovës (mbi 9km) e cila përdoret për mbikalime të avionëve civil është e deleguar përkohësisht nga NATO, në pajtim me institucionet e Kosovës, te *HungaroControl*, gjegjësisht Hungaria. Ndërsa hapësira e ulët ajrore (nën 9km) kontrollohet nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA) dhe në këtë hapësirë përdoren vetëm dy korridore për trafik komercial, për hyrje dhe dalje nga territori i Kosovës (XAXAN dhe SARAX) në kufi me Maqedoninë.

Për një operim plotësisht funksional në territorin e Republikës së Kosovës, shfrytëzimi i plotë i hapësirës është element thelbësor, prandaj për AAC-në realizimin e këtij objektivi ka rëndësi të theksuar.

*(a) Menaxhimi i hapësirës së lartë ajrore nga ASHNA*
*(b) Normalizimi i plotë i hapësirës së ulët ajrore për aviacion të përgjithshëm*
*(c) Hapja e korridorit ajror në hapësirën e ulët ajrore Kosovë - Shqipëri*
*(d) Hapja e korridorit ajror në hapësirën e ulët ajrore Kosovë - Mali i Zi*

**PLANI 2022:**

Edhe pse realizimi i këtij objektivi varet pjesërisht nga AAC-ja pra nga zhvillimet politike dhe veprimet e hisedarëve tjerë si NATO, AAC ka identifikuar veprime për të kontribuar në realizimin e këtij objektivi. Objektivi realizohet kur të arrihet delegimi i hapësirës së ulët ajrore te autoritetet e Kosovës- COMKFOR:

3.1 Normalizimi i plotë i hapësirës së ulët ajrore për aviacion të përgjithshëm

3.1.1 Koordinimi me Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror-ASHNA dhe Agjencinë Kadastrale për hartat VFR *(Publikimi dhe Distribuimi për industrinë)*

3.1.2 Aprovimi i hartave VFR (pas pranimit nga ASHNA) *(shënim: të shikohet legjislacioni për aprovim)*

3.1.3 Implementimi i Rregullores për shënjimin e pengesave *(ngjyrosja dhe ndriçimi)*

3.2 Përkrahje ASHNA-s në përgatitjen për:

*3.2.1 Menaxhimin e hapësirës së lartë ajrore*

*3.2.2 Hapjen e korridorit ajror në hapësirën e ulët ajrore Kosovë - Shqipëri*

*3.2.4 Hapjen e korridorit ajror në hapësirën e ulët ajrore Kosovë - Mali i Zi*

## 4. Objektivi: ANËTARËSIMI NË ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE

Është objektivë strategjike e AAC-së që të realizohet anëtarësimi i shtetit në Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO) e cila do të hapë pastaj rrugën për anëtarësim në Konferencën Evropiane të Aviacionit Civil (ECAC) dhe Organizatën Evropiane për Siguri të Navigacionit Ajror (EUROCONTROL).

*(a) Anëtarësimi në ICAO*
*(b) Anëtarësimi në ECAC*
*(c) Anëtarësimi në EUROCONTROL*

Anëtarësimi në ICAO është i domosdoshëm për një shtet për t'u trajtuar si partner i barabartë në fushën e aviacionit civil. Përmes këtij anëtarësimi do të mundësohet njohja ndërkombëtare e të gjitha certifikatave dhe licencave të aviacionit të lëshuara nga autoritetet tona, njohja e sovranitetit të plotë në hapësirën ajrore, marrja e kodit shtetëror për aeroporte, kodit të nacionalitetit për regjistrimin e avionëve në Kosovë, dhe marrja e shumë të drejtave tjera që i takojnë një shteti sovran në fushën e aviacionit civil.

**PLANI 2022:**

Realizimi i këtij objektivi është i lidhur ngushtë me njohjen e Republikës së Kosovës në rrafshin ndërkombëtar, megjithatë AAC mbështet institucionet relevante me përkrahje profesionale në drejtim të anëtarësimit të organizata ndërkombëtare.

4.1 Anëtarësimi në ICAO

4.1.1 Përkrahje teknike MPJ-së në procesin e aplikimit për anëtarësim në ICAO

4.2 Anëtarësimi në ECAC dhe në EUROCONTROL

4.2.1 Përkrahje teknike MPJ-së në procesin e aplikimit për anëtarësim. Hapat e radhës drejt anëtarësimit mund të fillojnë vetëm pas anëtarësimit në ICAO (pika 2.1)

## 5. Objektivi: LIDHJA E MARRËVESHJEVE TEKNIKE NDËRKOMBËTARE DHE RAJONALE

Lidhja e marrëveshjeve teknike me shtete tjera ka një rëndësi të veçantë për vendin tonë, duke ditur se Republika e Kosovës ende nuk është anëtare e barabartë e familjes ndërkombëtare të kombeve në fushën e aviacionit civil. AAC-ja shfrytëzon çdo mundësi ta prezantojë punën e autoriteteve tona dhe të thellojë bashkëpunimin me AAC-të e shteteve tjera. Lidhja e marrëveshjeve teknike është gjithashtu një mjet i rëndësishëm për shkëmbim përvojash dhe bashkëpunim me të gjitha autoritetet pjesëmarrëse.

*(a) Lidhja e aranzhimeve të punës me Agjencinë Evropiane për Siguri në Aviacion (EASA)*
*(b) Lidhja e marrëveshjeve teknike me shtetet e BE-së*
*(c) Lidhja e marrëveshjeve teknike me shtetet e rajonit*
*(d) Lidhja e marrëveshjeve teknike me shtetet tjera*

Lidhja e aranzhimeve të punës me EASA-n dhe lidhja e marrëveshjeve teknike me vendet e BE-së do t'i mundësojnë AAC-së qasje në bazën evropiane të të dhënave të sigurisë së aeroplanëve, do të krijojnë kornizën e nevojshme për inspektim të performancës së AAC-së nga EASA si dhe për asistencë nga EASA për zbatimin e plotë të dispozitave përkatëse të Marrëveshjes HPEA.

Bashkëpunimi me autoritetet homologe nga vendet e rajonit është i rëndësishëm për AAC-në, duke marrë parasysh se gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor janë duke kaluar nëpër të njëjtën sfidë - atë të harmonizimit të legjislacionit, rregullave e standardeve në aviacionin civil me ato të BE-së.

**PLANI 2022:**

5.1 Lidhja e marrëveshjeve për bashkëpunim me autoritetet e aviacionit civil ne Evrope dhe më gjerë
5.2 Vazhdimi i përpjekjeve për të lidhur aranzhime pune me EASA

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

CAA
Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

| | |
|---|---|
| Datë/Datum/Date: | 30.11.2021 |
| Për/Za/To: | Parlamentarna komisija za poljoprivredu, šumarstvo, ruralni razvoj, infrastrukturu i životnu sredinu, u Skupštini Republike Kosovo |
| Nga/Od/From: | **G. Bujar Ejupi**, Generalni direktor Autoriteta civilnog vazduhoplovstva Republike Kosovo |
| Lënda/Subjekat/Subject: | **Plan učinka Autoriteta civilnog vazduhoplovstva za 2022. godinu** |

Autoritet civilnog vazduhoplovstva Republike Kosovo je osnovan kao nezavisna regulatorna agencija, na osnovu člana 14. Zakona br. 03/L-051 o civilnom vazduhoplovstvu. Od 1. januara 2009. godine ACV je preuzeo puna ovlašćenja u skladu sa ovim zakonom. ACV je jedan od javnih organa sa odgovornostima i funkcijama u oblasti civilnog vazduhoplovstva u našoj zemlji.

ACV je odgovoran za regulaciju bezbednosnih aspekata civilnog vazduhoplovstva i ekonomsku regulaciju aerodroma i pružalaca usluga vazdušne navigacije. Ekonomska regulacija aerodroma i pružalaca usluga vazdušne navigacije podrazumeva odobravanje naknada za korišćenje usluga koje pružaju ovi operateri. ACV ima pune pravne kapacitete i za svoj rad odgovara Skupštini Republike Kosovo.

ACV je organizacija sa budžetskim prihodima i javnim ovlašćenjima i podleže relevantnim odredbama o budžetskim organizacijama i javnim organima u zakonima i drugim podzakonskim aktima koji su primenljivi u Republici Kosovo.

ACV je izradio i usvojio Strateške ciljeve za period 2019-2023. Plan rada u ACV-u se zasniva na strateškim ciljevima ACV-a, raščlanjuje ih na operativne ciljeve i detaljne radnje koje kao rezultat imaju pet internih dokumenata koji menadžment ACV-a prosleđuju na realizaciju u svakom tromesečju.

# PLAN UČINKA AUTORITETA CIVILNOG VAZDUHOPLOVSTVA KOSOVA 2022

## 1. Cilj: POTPUNA PRIMENA REGULATORNIH ODGOVORNOSTI

Politika ACV-a je da proveri da li su njegove radnje u potpunosti u skladu sa Zakonom o civilnom vazduhoplovstvu, sa ulogom i odgovornostima datim Autoritetu kroz ovaj zakon. Stoga je važno da ACV svake godine deluje kroz određene radnje u pravcu postizanja potpune primene regulatornih odgovornosti.

*(a) Sprovođenje Sporazuma o Zajedničkom evropskom vazduhoplovnom području (ZEVP)*
*(b) Dopune sekundarnog zakonodavstva*
*(c) Sertifikacija operatora*
*(d) Licenciranje vazduhoplovnog osoblja*
*(e) Odobrenje organizacija za obuku*
*(f) Stalni nadzor operatora*
*(g) Održavanje sistema za upravljanje kvalitetom i stalno unapređenje*

**PLAN ZA 2022. GODINU:**

1.1 Sprovođenje Sporazuma o ZAEVP-u

*1.2 Dopunjavanje sekundarnog zakonodavstva (Transpozicija akata iz EU acquis-a i izrada nacionalnog zakonodavstva)*

1.3 Primena plana korekcije za rešavanje nalaza EASA

1.4 Izdavanje i produženje licenci za osoblje operatora i izdavanje dozvola

1.5 Stalni nadzor operatera i interni nadzor

1.5.1 Revizije/Inspekcijski nadzor bezbednosti operatora AVNU

1.5.2 Revizije/Inspekcijski nadzor bezbednosti operatora MAP „Adem Jashari“ LKIA

1.5.3 Revizije/Inspekcijski nadzor bezbednosti zemaljskog opsluživanja

1.5.4 Revizije/Inspekcijski nadzor bezbednosti u:
- Odobrene organizacije za obuku (ATO)
- Za transport opasnih materija (DGR)
- Opšte vazduhoplovstvo (GAT)
- Vazduhoplovna medicina (MED)
- Inspekcijski nadzor platforme (SAFA)
- Organizacije za obuku u oblasti aerodroma i usluga zemaljskog opsluživanja

1.5.5 Interne revizije sistema upravljanja (sistem upravljanja kvalitetom i sistem upravljanja bezbednošću u vazduhoplovstvu)

1.5 Ekonomski nadzor AVNU-a, MAP "Adem Jashari" LKIA i zemaljskog opsluživanja

1.6 Razmatranje i analiza prijavljenih incidenata u vazduhoplovstvu

1.8 Regulisane vazduhoplovne naknade

1.9 Aranžiranje sporazuma o saradnji sa državnim organima za zaštitu životne sredine

1.10 Sprovođenje Uredbe o označavanju prepreka, posebno inspekcijski nadzor i identifikacija dalekovoda koji prolaze preko autoputeva

1.11 Vazduhoplovne procene za konstrukcije unutar zaštitnih zona aerodroma, kao i visokih objekata na celoj teritoriji Republike Kosovo, posebno vetroturbina

## 2. Cilj : **SPROVOĐENJE NACIONALNOG PROGRAMA BEZBEDNOSTI (NPB)**

Sprovođenje Nacionalnog programa bezbednosti je obaveza Republike Kosovo koja proizilazi iz Aneksa 19 ICAO-a. Vlada Kosova je delegirala na Generalnog direktora ACV odgovornost za praćenje i koordinaciju sprovođenja ove obaveze na nacionalnom nivou.

Putem NPB-a zahteva se izrada i sprovođenje zajedničkog programa, koji jasno definiše strukturu i hijerarhiju odgovornosti države u bezbednosti civilnog vazduhoplovstva, definiše uloge zainteresovanih strana i koordinaciju rada između njih. Ovaj program takođe definiše državnu politiku za bezbednost i sprovođenje važećeg zakonodavstva.

Zahtevi NPB-a su grupisani u četiri glavna stuba,

*(a) Državna politika i ciljevi za bezbednost (pravni okvir za civilno vazduhoplovstvo, podela odgovornosti za bezbednost vazduhoplovstva unutar države, istrage nesreća i incidenata i državna politika za obavezu sprovođenja zakonodavstva o civilnom vazduhoplovstvu)*

*(b) Upravljanje bezbednosnim rizikom (državni zahtevi za Sistem upravljanja bezbednošću (SUB) za operatere, sporazum o učinka bezbednosti od operatera, državni pokazatelji bezbednosti)*

*(c) Garancija bezbednosti (Nadgledanje bezbednosti, prikupljanje, analiza i razmena bezbednosnih podataka, identifikacija najosetljivijih oblasti na osnovu bezbednosnih podataka)*

*(d) Promocija bezbednosti (interna i eksterna obuka, komunikacija i distribucija informacija)*

**PLAN ZA 2022. GODINU:**

Za sprovođenje NPB-a i postizanje zrelosti ovog programa potrebno je duže vreme i dugoročno planiranje jer je broj zahteva veliki i za njihovo ostvarivanje je odgovorno više institucija sa ulogom u bezbednosti civilnog vazduhoplovstva zajedno sa vazduhoplovnim operaterima,

međutim ACV je odgovoran za ostvarivanje većine zahteva i odgovoran za koordinaciju realizacije ovog programa, uz posvećenost planira i sprovodi radnje za postizanje ovog cilja.

2.1 Ostvarivanje zahteva NPB-a koji se odnose samo na ACV

2.2.1 Koordinacija radnji sa institucijama i operaterima sa ulogom u NPB

## 3. Cilj: NORMALIZACIJA VAZDUŠNOG PROSTORA

Gornji vazdušni prostor Republike Kosovo (preko 9km) koji se koristi za prolaz civilnih vazduhoplova, privremeno delegira NATO, uz dogovor sa institucijama Kosova, u *HungaroControl*, odnosno Mađarskoj. Dok donji vazdušni prostor (ispod 9km) kontroliše Agencija za vazdušno-navigacijske usluge (AVNU) i u ovom prostoru se koriste samo dva koridora za komercijalni saobraćaj, za ulazak i izlazak sa teritorije Kosova (XAXAN i SARAX) na granici sa Makedonijom.

Za potpuno funkcionalno delovanje na teritoriji Republike Kosovo, potpuno korišćenje prostora je suštinski element, stoga je za ACV ostvarivanje ovog cilja ima istaknutu važnosti.

*(a) Upravljanje gornjim vazdušnom prostoru od strane AVNU*
*(b) Potpuna normalizacija donjeg vazdušnog prostora za opšte vazduhoplovstvo*
*(c) Otvaranje vazdušnog koridora na donjem vazdušnom prostoru Kosovo – Albanija*
*(d) Otvaranje vazdušnog koridora na donjem vazdušnom prostoru Kosovo – Crna Gora*

**PLAN ZA 2022. GODINU:**

Iako ostvarivanje ovog cilja delimično zavisi od ACV-a, odnosno od političkih dešavanja i delovanja drugih zainteresovanih strana kao što je NATO, ACV je identifikovao radnje koje će doprineti ostvarivanju ovog cilja. Cilj se postiže kada se postigne delegiranje donjeg vazdušnog prostora kosovskim vlastima - COMKFOR:

3.1 Potpuna normalizacija donjeg vazdušnog prostora za opšte vazduhoplovstvo

3.1.1 Koordinacija sa Agencijom za vazdušno-navigacijske usluge – AVNU i Katastarskom agencijom za VFR karte *(Objavljivanje i distribucija za industriju)*

*3.1.2* Odobrenje VFR karta (po prijemu od AVNU) *(napomena: pregledati zakonodavstvo radi odobrenja)*

3.1.3 Sprovođenje Uredbe o obeležavanju prepreka *(bojenje i osvetljenje)*

3.2 Podrška AVNU za pripremu:

*3.2.1 Upravljanje gornjim vazdušnim prostorom*

*3.2.2 Otvaranje vazdušnog koridora na donjem vazdušnom prostoru Kosovo – Albanija*
*3.2.3 Otvaranje vazdušnog koridora na donjem vazdušnom prostoru Kosovo – Crna Gora*

## 4. Cilj: ČLANSTVO U MEĐUNARODNIM ORGANIZACIJAMA

Strateški cilj ACV-a je postizanje članstva države u Međunarodnoj organizaciji civilnog vazduhoplovstva (ICAO) koja će otvoriti put za članstvo u Evropskoj konferenciji civilnog vazduhoplovstva (ECAC) i Evropskoj organizaciji za bezbednost vazdušne plovidbe (EUROCONTROL).

*(a) Članstvo u ICAO*
*(b) Članstvo u ECAC*
*(c) Članstvo u EUROCONTROL*

Članstvo u ICAO-u je od neophodno za jednu zemlju da bi se tretirala kao ravnopravan partner u oblasti civilnog vazduhoplovstva. Ovo članstvo će omogućiti međunarodno priznavanje svih vazduhoplovnih sertifikata i licenci koje izdaju naše vlasti, priznavanje punog suvereniteta u vazdušnom prostoru, dobijanje državnog koda za aerodrome, nacionalnog koda za registraciju aviona na Kosovu i dobijanje mnogih drugih prava koja pripadaju suverenoj zemlji u oblasti civilnog vazduhoplovstva.

**PLAN ZA 2022. GODINU:**

Ostvarivanje ovog cilja je usko povezana sa priznavanjem Republike Kosovo na međunarodnom planu, međutim ACV podržava relevantne institucije stručnom podrškom u pravcu članstva u međunarodnim organizacijama.

4.1 <u>Članstvo u ICAO</u>

4.1.1 Tehnička podrška MIP-u u procesu apliciranja za članstvo u ICAO

4.2 <u>Članstvo u ECAC i u EUROCONTROL</u>

4.2.1 Tehnička podrška MIP-u u procesu apliciranja za članstvo. Naredni koraci u pravcu članstva mogu početi samo nakon članstva u ICAO (tačka 2.1)

## 5. Cilj: ZAKLJUČIVANJE MEĐUNARODNIH I REGIONALNIH TEHNIČKIH SPORAZUMA

Zaključivanje tehničkih sporazuma sa drugim zemljama je od posebnog značaja za našu zemlju, znajući da Republika Kosovo još uvek nije ravnopravan član međunarodne porodice nacija u oblasti civilnog vazduhoplovstva. ACV koristi svaku priliku da predstavi rad naših organa i produbi saradnju sa ACV-ima drugih zemalja. Zaključivanje tehničkih sporazuma je takođe važno sredstvo za razmenu iskustava i saradnje sa svim organima učesnicima.

*(a) Zaključivanje radnih aranžmana sa Evropskom agencijom za vazduhoplovnu bezbednost (EASA)*
*(b) Zaključivanje tehničkih sporazuma sa zemljama EU*
*(c) Zaključivanje tehničkih sporazuma sa zemljama u regionu*
*(d) Zaključivanje tehničkih sporazuma sa drugim zemljama*

Zaključivanje radnih aranžmana sa EASA-om i zaključivanje tehničkih sporazuma sa zemljama EU omogućiće ACV-u pristup Evropskoj bazi podataka o bezbednosti vazduhoplova, stvoriće neophodan okvir za inspekcijski nadzor učinka ACV od strane EASA, kao i pomoć EASA za punu implementaciju relevantnih odredbi Sporazuma o ZAEVP-u.

Saradnja sa homolognim organima iz zemalja u regionu važna je za ACV, s obzirom da sve zemlje Zapadnog Balkana prolaze kroz isti izazov – usklađivanje zakonodavstva, pravila i standarda u civilnom vazduhoplovstvu sa onima iz EU.

**PLAN ZA 2022. GODINU:**

5.1 Zaključivanje sporazuma o saradnji sa autoritetima civilnog vazduhoplovstva u Evropi i šire
5.2 Nastavak napora za zaključivanje radnih aranžmana sa EASA-om.